

AKT THEMELIMI

I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“DALO” SHPK .

Ortakët themelues të Shoqërisë :

Z. **Nicola DALO'**, i biri Domenico-s shtetas Italian, dtl.10/12/1968, lindur në Barleta (Bari) Itali dhe banues në Barleta (BARI) Rruga Della Casa Comunale nr1 . Carta e Identitetit Nr.AV8403859;

bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”,

mbledhur në Durres sot më datë 11/02/2019,

VENDOSËN:

Të krijojnë së bashku një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim hartojnë dhe miratojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1. Emri

1.1 Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj **“DALO” SHPK**.

1.2 Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të saj.

NENI 2 Forma juridike

P W

2.1 Shoqëria tregtare “DALO” SHPK .ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

2.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër juridike me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve sipas përcaktiveve në ligj dhe në Statutin e saj.

NENI 3

Selia

3.1 *Selia e Shoqërisë ndodhet në Rrugen Aleksander GOGA perballë Drejtoris se Policis Durrës*

3.2 Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë.

3.3 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve shoqëria mund të hapë degë të saj apo Zyra përfaqësimi në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.

NENI 4

Vula e shoqërisë

4.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj.

4.2 Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar;

NENI 5

Objekti i Veprimtarisë

5.1 Shoqëria ka si objekt veprimtaritë si më poshtë:

- - Kerkim, zhvillim dhe shitjen e prodhimit, sherbim informatik, editor, Veshembadje Edicion, libra dhe revista duke perfshire publicitet publikime leter dhe video. dministrim finansiar e te mirave materiale Import eksport dhe tregëtim me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm industrialë, ushqimoreë, bujqësorë, blektoralë, Formim Hoteleri - Turizem. Imobiliare blerje e shitje e cdo lloje per vete dhe per llogari te trete.


5.2 Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

NENI 6

Kohëzgjatja e Shoqërisë.

6.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje për një afat të pacaktuar.

6.2 Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.



Neni 7
Kapitali i shoqërisë dhe Kuotat

7.1 Kapitali i rregjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i ortakëve në vlerën 100.000 lekë.

- **Z. Nicola DALO'**, zotëron një kuotë me vlerë 100000 (njeqindmijë) lekë, që përfaqëson 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

7.2 Ortakët, në bazë të kërkesës së organit administrues, mund të sjellin para në shoqëri sipas marrëveshjes paraprake të lidhur midis tyre. Kjo derdhje parash mund të bëhet në formën e zmadhimit të kapitalit ashtu si dhe në formën e financimit të shoqërisë. Në rastin e financimit të shoqërisë nga ortakët në formë huaje, nuk është e nevojshme të respektohet përpjesshmëria mes shumës së derdhur në shoqëri dhe kuotave të kapitalit që ortakët zotërojnë.

7.3 Nëse mes palëve nuk ka akorde specifike, financimet në formë huaje të bëra nga Ortakët do të konsiderohen si hua pa interes.

NENI 8
Organet e Shoqërisë

8.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

8.2 Kompetencat, të drejtat dhe detyrat e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 9
Administratori

9.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

9.2 Administrator i Shoqërisë do të jetë **Z. Nicola DALO'**

NENI 10
Dispozita të fundit

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar në fuqi. Përsa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit, dhe në Statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare», Kodit Civil dhe legjisacionit në fuqi.

NENI 11
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve




Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt themelimi përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore, njëra nga të cilat qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES

Nicola DALO'



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Nicola DALO'" above a stylized, cursive name that looks like "DOD KOSA". Below this is another smaller, less distinct signature.